



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 22.05.2023

Nr: 122

Ora: 13:10

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 66, DATË 20.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: "Partia Lëvizja e Legalitetit"

OBJEKT: Kundërshtim i vendimeve nr. 808, datë 16.05.2023, të KZAZ nr. 41 dhe vendimit nr. 1461, datë 16.05.2023, të KZAZ nr. 37, Tiranë "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit bashkiak Tiranë"

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia "Lëvizja e Legalitetit" ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 66 regj., datë 20.05.2023.

Në mbledhjen e datës 22.04.2023, ora 13:10, pas relatimit të z. Ledio Braho, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 66 nuk i plotësonte kërkesat e nenit 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

KAS vihet në lëvizje nga subjektet me të drejtën e tyre për ankim ndaj vendimit për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Kërkesa nr. 66, është regjistruar në KQZ në datën 20.05.2023, pra 1 (një) ditë para marrjes së vendimit nr. 542, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", i cili është marrë në datën 21.05.2023.

Në këto rrethana, kërkesa ankimore është pa objekt të ligjshëm dhe për pasojë nuk merret në shqyrtim nga KAS. KAS është kompetent për ankesat ndaj vendimit për shpalljen e rezultatit dhe jo për ankesat ndaj vendimeve të KZAZ-ve të veçanta.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja "b", të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 66, datë 20.05.2023, të paraqitur nga Partia Lëvizja e Legalitetit.

2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot, më datë 22.05.2023

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar